



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3840 prot.

Vlorë, më 20.05 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. 2026

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
PËRMBYTJA E BANESËS TË ZNJ.RUDINA LAZEMETAJ DHE SHPËRBLIMIN
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmytja në banesën e znj.Rudina Lazemetaj, e ndodhur në, Orikum, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, në datën 18.02.2026, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- A. 50,448(pesëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e tetë) lekë për punime ndërtimi (100,896x50%).

B. 685,056(gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

ME URDHËR DELEGIMI

NËNKRYETAR

Joljana Llanaj

